

SHOQËRIA ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR
GREEN COAST SH.P.K.
ME SELI NË RR. DERVISH HIMA, PALLATI AMBASADOR 3, KATI 4, TIRANË, SHQIPËRI
REGJISTRUAR PRANË REGJISTRIT TREGTAR ME NUMËR UNIK IDENTIFIKIMI
L41329038D

VENDIM
I
ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË

Sot, më 09.07.2021 në orën 11.00, në selinë e Shoqërisë "**Green Coast**" sh.p.k., regjistruar në regjistrin tregtar me numër identifikimi L41329038D, me adresë në Njesia Bashkiake nr.2, rruga "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, Kati 4, Apartamenti 31, Tiranë, Shqipëri (më tej referuar si "**Shoqëria**"), mbahet mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, me të pranishëm:

Balfin - Balkan Finance Investment Group Sh.p.k., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar në përputhje me legjislacionin shqiptar, me NUIS K72223031K dhe seli të regjistruar në adresën Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA Business Center, Tiranë, Shqipëri, me ortak të vetëm, Z. Samir MANE, e cila zotëron 100% të kapitalit të Shoqërisë, e përfaqësuar ligjërisht nga znj. Edlira Muka në cilësinë e administratores së shoqërisë Balfin sh.p.k. ("**Ortaku i Vetëm**").

Znj. Edlira Muka e cila merr përsipër të kryesojë mbledhjen, fton znj. Rozana Kodrari e cila pranon, të kryejë funksionin e sekretarit. Kryetari i Asamblesë pasi deklaroi vullnetin e Ortakëve për të vendosur për çështjet në rendin e ditës, e deklaroi Asamblesë të Përgjithshme të Shoqërisë të mbledhur rregullisht bazuar në paragrafin e dytë të nenit 83 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" dhe të aftë për të marrë vendime të vlefshme mbi rendin e ditës si në vijim

RENDI I DITËS

- I. ZVOGËLIMI I KAPITALIT TË SHOQËRISË
- II. TË NDRYSHME

Në lidhje me pikën e parë në Rend të Ditës, Kryetari parashtroi se kapitali aktual i Shoqërisë është 2.658.582.828 LEK (dy miliard e gjashtëqind e pesëdhjetë e tete miljen e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e njetë e tete lekë). Në kushtet kur veprimtaria e Shoqërisë po procedon kënaqshëm dhe situata financiare është e ne përputhje me pritshmërinë me pozitive të Ortakut, është propozuar nga ana e Ortakut të Vetëm mundësia për rimarrjen e një pjese të kontributit të dhënë në shoqëri në vlerën prej 2.000.000 Euro (dy milion euro) nëpërmjet zvogëlimit të kapitalit.

Pas një vlerësimi të kujdesshëm, Asambleja:

VENDOS:

- A. Miratimin e zvogëlimit të kapitalit të Shoqërisë me 2.000.000 Euro (dy milion euro) e barasvlershme me 245,060,000 ALL me kursin e Bankës së Shqipërisë të datës 09.07.2021 prej 1 Euro = 122.53 Leke dhe kthimi e kontributit në favor të Ortakut të Vetëm.
- B. Kapitali i Shoqërisë nga 2.658.582.828 LEK (dy miliard e gjashtëqind e pesëdhjetë e tete miljen e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë e tetëqind e njetë e tete lekë)

bëhet **2,413,522,828 LEK** (dy miliard e katërqind e trembëdhjete milion e pesëqind e njëzete e dy mijë e tetëqind e njëzete e tete lekë).

C. Të autorizojë Administratorin e shoqërisë Green Coast Sh.p.k., për të kryer të gjitha aplikimet e nevojshme me qëllim regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ("QKB"), ose të autorizojë persona të tjerë përkatësisht për këto veprime.


D.

Meqenëse nuk pati asnjë çështje tjetër për të diskutuar, Kryetari e deklaroi mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë të mbyllur në orën 11.30. Ky vendim i Asamblesë së Përgjithshme mbahet në formën e procesverbalit, në përputhje me nenin 90 të Ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

KRYETARI

BALEIN
Balkan Finance Investment Group
Znj. Edlira Muka 

SEKRETARI


Znj. Rozana Kodrari